



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 210/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Hasan Shala anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterave në objekte, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.10.2017, mori këtë:

VENDIM

KONSTATOHET tërheqja e ankesës e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, ZL. A.nr. 210/2017 të datës 13.10.2017.

Arsyetim

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren ka paraqitur ankesë në PZAP kundër Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike në Prizren të kandidatit për kuvend Komunal në Prizren nga radhët e LDK-së, për Zgjedhjet Lokale 2017.

Me datë 14.10.2017, ankuesi ka parashtruar kërkesë me nr. Protokoli 210/3 për tërheqjen e ankesë me numër: Anr.210/2017 të datës 13.10.2017

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.210/2017 më datën 16.10.2017.

